

**Shërbim shtëpiak privat**

**Një KKP për kujdestarët shtëpiak**

**2**

**Pjesa e dytë intervistës**

**KKP për personelin e huazuar!**

**3**

**Marrëveshja për pensionet**

**Dështimi i qeverisë së Kosovës**

**4**

Nr. 5 | shtator 2013 | shqip

Botohet si shtojcë në gazetën «work» | Redaksia T +41 31 350 21 11, F +41 31 350 22 11 | info@unia.ch | www.unia.ch

**Shegertët, të drejtat dhe obligimet**

## Të drejtat e shegertëve: Përgjigjet më të rëndësishme!



Pamje me shkollarë që vijojnë aftësimin profesional

**Para disa javësh në Zvicër ka filluar përsëri viti i aftësimin profesional. Fillimi i këtij aftësimi paraqet nisjen e jetës profesionale. Përgjegjësia rritet dhe, gjithnjë më shumë njerëz, presin më shumë kontribut të mirë nga të rinjtë: Mësimdhënësve të zejes dhe prindërve ua shtohen edhe firmat dhe trajnuesit. Ndërsa fillon edhe situatë të re: Përditshmëria nuk përbëhet më vetëm nga «rregullat», porse nga «ligjet». Për tu gjetur në këtë situatë të re fillestarët dhe prindërit e tyre, në vijim keni këshillat më të rëndësishme të Horizontit.**

### Orari i punës

Si shegertë ti nuk guxon të punosh më shumë se 9 orë në ditë. Edhe atëherë kur në ndërkohë bënë pauzë, duhet që këto nëntë orë pune të ndahen në më pak se 12 orë në ditë. Nëse ti nuk je ende 18 vjeç, vlen edhe mbrojtja ligjore e të rinjve: Ti fillon me punë jo më herët se në ora 6 dhe ndërpre punën më së voni në ora 22. Mirëpo, ashtu si u tha më lartë, jo përmjeherë. Shkolla profesionale vlen si kohë pune. Orari i tepër, kjo d.m.th. koha e punës, e cila tejkalon orarin e punës në ndërmarrje, për të rinjtë që vijojnë aftësimin profesional ndalohet. Përpos në situatë të jashtëzakonshme në ndërmarrje. Këto situatë janë definuar rreptë.

### Papunësia

Nëse ti gjatë apo pas aftësimin profesional mbetesh i papunë, ke të drejtë në përfitim parash të papunësisë. Për këtë duhet lajmëruar në entin regional për ndërmjetësimin e punës (RAV). Ligji i papunësisë rishtas është ashpërsuar para së gjithash për të rinjtë: Ti tani duhet të presësh më gjatë për të marrë pagesën e parave ditore. Dhe ti nga kjo ke të drejtë të përfitosh për një kohë më të shkurtër. Kushtet varen edhe nga situata e jote familjare (p.sh. nëse vet keni fëmijë) dhe nga kontributet paguara deri më tani në Sigurimet Shoqërore.

### Mungesat

Nëse ti mungon në punë apo në shkollë, duhet ta arsyetosh mun-

gesën: Paga nuk guxon të shkurtrohet nëse ti mungon për arsyet e mëposhtme:

- shërbim ushtarak
- termin me zyrtarë
- ngjarje familjare

Mund të ndodh që ty të duhet të parashtrosh paraprakisht kërkesë. Të mungosh nga puna apo nga shkolla ke të drejtë edhe për shkaqe sëmundjeje apo aksidenti.

Për dy ditët e para të mungesës në rastet e cekura mjafton arsyetimi me gojë. Nga dita e tretë shkolla apo ndërmarrja mund të kërkojë vërtetim me shkrim. Për kontrollat mjekësore gjatë orarit të punës duhet marrë leje. Parregullsitë, të cilat ti nuk mund ti arsyetosh vlejnjë si mungesa të paarsyeshme. Këto do të shënohen në dëftesë, ndërsa vonesa p.sh. për shkak të vonimit të trenit nuk shënohet.

### Kontrata e arsimimit profesional

Kontrata për mësimin e zejes nuk është thjeshtë kontratë pune. Fjala është për kontratë për mësimin e

zejes. Ndërmarrja obligohet që të ta mësojë zejen.

Ndërsa edhe ti obligohesh të punosh në ndërmarrje. Në kontratë duhet të qëndrojnë profesionit, kohëzgjatja dhe përfundimi i aftësimin profesional. Gjithashtu paga, pushimet, heqjet, harxhimet tjera, etj. janë pjesë përbërëse të Kontratës. Ti mund ta nënshkruash vetë, vetëm nëse ke arrit moshën madhore. Para kësaj moshe duhet ta nënshkruajnë prindërit tu.

☞ Aurora Garcia

### Të drejtat e mija

Përgjigjet në pyetjet e këtij artikulli janë marrë nga broshura këshillëdhënëse e sindikatës «Unë i njoh të drejtat e mija». Nga A sie Abs-tinencat deri tek Z si provimet e ndërmjetme i gjen në te gjithëcka që ka të bëjë me të drejtat e shegertëve. Broshurën mund ta gjeni tek Unia dhe tek Unioni i Sindikata-ve të Bashkuara të Zvicrës (SGB). Shkarkimin mund ta bëni nga vega: [www.gewerkschaftsjugend.ch](http://www.gewerkschaftsjugend.ch)

### Editorial



### Paga të drejta – edhe për shegertët

Aktualisht në Zvicër jetojnë më shumë se 440 000 njerëz nën minimumin jetik edhe përkundër faktit se punojnë në orar të plotë. Nuk ka arsye të jetë kështu, pasi Zvicra është ndër shtetet më të pasura të botës dhe mirëqenia në vitet e fundit është rritur edhe më tej. Shkaqet e këtij zhvillimi: Një pakicë njerëzish merr gjithnjë më shumë nga pjesa e kulaçit të mirëqenies së krijuar bashkërisht. Bie fjala Daniel Vasella. Ish menaxheri i Novatris-it në kohët e tija më të mira fitonte 720 herë më shumë se sa i punësuarit i tij i paguar më së dobëti.

Ka vite që po luhet loja e njëjtë: Pagat lartë janë duke eksploduar, ndërsa poshtë stagnojnë. Posaçërisht të prekur nga kjo tendencë janë të rinjtë. Pagat e shegertëve nuk janë rritur fare dhe edhe pas mësimit të zejes nuk është më mirë. Më se 143 000 njerëz edhe përkundër të përfundimit të aftësimin profesional marrin një pagë nën 4000 franga. Ky fakt nënvleftëson aftësimin profesional. Pse duhet të mësohet një zeje a profesion, nëse në të ardhmen nga kjo nuk mund të jetohej? Sistemi arsimor i dyfishtë profesional deri tani u ka mundësuar shumicës së të rinjve që të mësojnë një zeje a profesion, i cili atyre u pëlqen me çka zbutet edhe papunësia tek rinia.

Ne duhet ti obligomë punëdhënësit dhe të gjithë bashkë të kujdesemi për paga të drejta. Me votimin e iniciativës 1:12 në nëntor ne i kufizojmë pagat e hileqarëve mashtrues dhe të kujdesemi që të mbetet më shumë edhe për të gjithë të tjerët. Përmes iniciativës për pagën minimale ne mundësojmë që të gjithë të jetojnë nga paga e tyre. Ndërsa përmes Kontratave të mira Kolektive të Punës, të cilave u nënshtrohen edhe shegertët, mundësojmë gjithashtu ngritje të pagave për të gjithë të tjerët!

**Fabian Molina**  
Sekretar për rini në Unia

News

**AHVplus: Iniciativa e grumbulluar në afat rekord**

Iniciativa AHVplus ka arritur të grumbullojë në afat rekord 16000 nënshkrime! Pas vetëm 100 ditëve grumbulluese Unia ka plotësuar kuotën grumbulluese, shumë regjione kanë tejkaluar kuotën e tyre. Faleminderit shumë për angazhimin e juaj të jashtëzakonshëm!

**KKP Siguria 2014**

Konferenca e sektorit të anëtarëve të sigurisë më 4 qershor ka aprovuar KKP e rinovuar në disa pjesë. Kjo tani për shumë punëmarrës që janë të punësuar orar të kufizuar orësh pune, bie me veti punësimin e përhershëm me pagë mujore dhe me këtë edhe pagë më lartë dhe sigurti në të ardhura. Një arritje tjetër e rëndësishme është evidencimi sistematik i kohës së punës. Kompensimi i harxhimeve të udhëtimit dhe kohës së udhëtimit gjithashtu rregullohet me kontratën e re.

**ILO-Konventa për shërbëtorët shtëpiak**

Qeveria federale ka miratuar në fund të muajit gusht deklaratën për ratifikimin e Konventës Ndërkombëtare të Punës të vitit 2011 (Konventa Nr. 189) mbi shërbëtorët shtëpiak. Konventa parasheh ndër të tjera edhe barazinë edhe të shërbëtorëve shtëpiak me të punëmarrësit tjerë. Konventa përbënë pos tjerash rregullat mbi kushtet e punës dhe të jetës si orari i punës dhe rritja e pagës. Tani pritë ratifikimi i Konventës në parlament.

**KKP e re e Coo-it 2014-2017**



Coop-i dhe Unia si dhe katër shoqata tjera të punëmarrësve kanë nënshkruar një Kontratë të re Kolektive të Punës për katër vitet e ardhshme. Kontrata e re bie mbrojtje më të mirë për punëmarrësit aktiv në sindikatë, përmirësime me rastin e planit social si dhe me rastin e pushimit të lehonisë dhe atë të atësisë. KKP në mënyrë eksplicite precizon se një shkarkim nga puna nuk mund të merret nëse dikush është i zgjedhur në funksion të organizatës së punëmarrësve. Kjo është një arritje falë angazhimit të aktivistëve sindikal (personave të besuar), të cilët janë angazhuar përmes një peticioni.

Intervista, politika e azilit

**Ndalesë rajoni për refugjatët?**

**Në Bremgarten (AG) këtë verë u hap një qendër federale për refugjatë, të cilët janë në pritje të procedurave. Me këtë rast federata bëri një marrëveshje të ashtuquajtur ndalesë rajoni me komunën, përmes së cilës refugjatët duhet të mbahen larg zonave dhe vendeve të caktuara (shkollat, bazonet, bibliotekat, etj.). Në lidhje me këto masa të ndërmarra, Horizonte bisedoj me juristin Tarek Naguip, i cili njëherazi është edhe specialistin për çështje anti-diskriminuese.**



Juristi Tarek Naguip gjatë ligjërimit

**Si e vlerëson Ti ndalesën e rajonit për refugjatë në Bremgarten?**

Një ndalesë e tillë rajoni, së paku në aspektin juridik, nuk ekziston. Mirëpo si duket në një marrëveshje të parë me Bremgarten është shënuar se, është mundur një lloj «disiplinimi» i azilkërkuësve përmes rregullit shtëpiak. Të dyja janë në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare dhe kushtetutën e vendit. Ky është mendimi edhe i ministres Simonetta Sammaruga. Vet debati për fuqizimin e një ndalesë të tillë rajoni është tepër problematik: Azilkërkuësit ka vite që iu janë nënshtruar një diskursi stigmatizues, i cili faktikisht ua kufizon të drejtat atyre. Posaçërisht në rastet kur tako-

hen me njerëz, gjithnjë e më shpesh shpallen si të padëshirueshëm.

**A ka të drejtë shteti të kufizojë kështu lirinë e lëvizjes të një grupi njerëzish?**

Pa bazë ligjore jo. Mirëpo edhe në rast të tillë një masë e tillë do të ishte në kundërshtim ligjor të dyfishtë: Së pari vetë kërcënimin me sanksione një kufizimi disproporcional i lirisë së lëvizjes. Sipas vendimeve udhërrëfyese të gjyqit federal, për një azilkërkuës të vetëm edhe mund të vendoset ndalesë rajoni. Mirëpo nuk është e ligjshme, që të kufizohet paushallë liria e lëvizjes për një grup të njerëzve. Së dyti, sipas mendimit tim një masë e tillë është diskriminuese, pasi prek

njerëzit që ka vite që i nënshtrohen stigmatizimit dhe të cilët nuk kanë mundësi ti ikin kësaj.

**Si i vlerëson Ti zhvillimet e mëtejme në politikën zvicerane të azilit?**

Pyetje e vështirë. Tendenca restriktive mbetet në afatin e shkurtë dhe të mesëm kështu si është tani për tani. I shkon shumë përshtati me luftës zgjedhore. Në afatgjatë ndoshta Evropa do të mësojë: pasi me kundërtënie aktuale nuk mund të vijohet më tej: në njërin anë dëshirohet të qohen përpara interesat ekonomik e gjeostrategjike, çka prodhon lëvizje refugjatësh drejt Evropës. Në anën

tjetër kur refugjatët vijnë, forcohen muret e kufijve tanë.

**Si mund të ndikojë sindikata në politikën e azilit?**

Duke u kujdesur ndër të tjera për interesat e punëmarrësve, pavarësisht nga statuti juridik që kanë migrantët dhe punonjësit. Dhe duke qenë syhapur dhe e angazhuar kundër diskriminimit të grupeve të personave. Pasi azilkërkuësit janë njerëz, të cilëve u nevojitet mbrojtje. Dhe ata janë njerëz, që pasurojnë shoqërinë tonë: si fqinjë, miq dhe koleg (të ardhshëm) pune.

Emine Sariaslan

**Koment i redaksisë në lidhje me politikën aktuale të azilit**

Refugjatët, të cilët kërkojnë azil në Zvicër, gjatë zgjatjes së procedurës vendosen nëpër qendra. Në shumë vendbanime qytetarët nuk i dëshirojnë këta qendra, nga frika e të panjohurës. Kjo frikë në diskursin e zgjeruar publik shfrytëzohet për nxitje kundër të huajve e veçanërisht kundër refugjatëve. Pasi atmosfera në Zvicër dhe Evropë nuk shquhet nga klima e pranimit i tjetrit, porse nga klima e demonizimit. Refugjatët i takojnë grupit më të dobët ndër të dobët, statusi i tyre i qëndrimit është shumë i pasigurt dhe ata kanë nevojë për mbështetje. Ata i kanë ikur luftës dhe përndjekjes, shpesh janë së tepërmi të traumatizuar. Në vendin, ku kërkojnë mbrojtje ata stampohen si kriminel dhe si parazit, që jetojnë nga shteti. Si të tillë në Zvicër nuk kanë të drejtë të punojnë dhe janë të së tepërmi pasiv e të pa angazhuar dhe posedojnë shumë pak para, për të mbuluar nevojat elementare. Të ofrohet refugjatëve një vendstrehim kundër përndjekjes dhe dëbimit do të ishte detyrë e rëndësishme e një shteti ligjor e demokratik. Kështu popullata do të tregonte më shumë mirëkuptim për njerëzit, të cilët janë të rrezikuar në vendet e tyre. Pasi: nëse përndjekja e njeriut apo të afërmeve, nëse tortura, burgu, vdekja përgjojnë në çdo kënd, çka është më natyrisht se të kërkoet një vend i sigurt? Çka do të bënim ne në një situatë të ngjashme?

Kujdesi në ekonominë familjare private

**Një KKP për shërbimet në ekonominë shtëpiake!**

**Më 23 gusht 2013 u mbajt konferenca e 2-të e sektorit «kujdesi në ekonominë familjare private». Rreth 20 delegatë, të cilët në ekonominë shtëpiake private kujdesen për të moshuarat dhe të moshuarit, diskutuan për mundësitë e përmirësimit të kushteve jashtëzakonisht të këqija të punës dhe jetës.**

Sektori i kujdesit në ekonominë familjare private është duke u rritur. Kushtet e punës për të punësuarit në këtë sektor, që kryesisht janë gra, karakterizohen nga pagat e ulëta, punë me porosi, prezencë e pandërprerë 24 orësh dhe, posaçërisht tek migrantet, nga një izolim i konsiderueshëm social.

**«Badanti» në Ticino**

Se sa të vështira mund të jenë kushtet e punës, tregon shembulli i rreth 300 polakeve, të cilat punojnë si «badanti» (kujdestare) në Ticino. Ato jetojnë në shtëpinë e punëdhënësit, s'kanë kohë të lirë, marrin



Pamje të grave polake me drejtues dhe sekretar të Unia-s

një pagë tejet të ulët dhe në rastin më të keq edhe keqtrajtohen nga punëdhënësit. Për këto arsye në disa raste kanë ndodhur edhe vetëvrasje, siç është rasti i Bogusia-s. Fati i saj ka tronditua aq fortë shoqet e saj sa që ato murrën vendimin të

mbrohen dhe të luftojnë për kushte më të mira. Ato u organizuan me ndihmën e Unia-s dhe angazhimi i tyre mundësoj rritjen e presionit të nevojshëm politik, për të filluar fillimin bisedimeve për KKP në kanton. Në konferencën e sektorit delegatët

shprehën solidaritetin me koleget e tyre polake të Ticino-s.

**KKP për kushte më të mira pune**

Kontratës Kolektive të Punës është potencuar si e rëndësishme së jashtëzakonshme. Jo vetëm në Ticino është duke u negociuar KKP, edhe në Zvicrën gjermano-folëse kanë filluar bisedimet me shoqatën e punëdhënësve «Të jetojmë në shtëpi». KKP nuk do të rregulloj vetëm orari i punës dhe kohën e pushimit, por edhe kompensimin më të lartë, si p-sh. edhe për kohën e bërjes së rrugës për ne pune dhe të ndalojë mundësinë porositjes të punës në gatishmëri në çdo kohë. Njohja e kompetencave formale dhe joformale të kujdestarëve si dhe mundësia për trajnim e arsimim të mëtejme gjithashtu është njëra nga kërkesat me prioritetet i konferencës së delegatëve. Delegatët prezentë krahas kushteve më të ra të punës kërkuar pos tjerash edhe kontrolle kundër punëdhënësve keqtrajtes dhe më shumë përgjegjësi sociale të zyrtarëve publik.

Aurora Garcia

**Bisedimet personeli i huazuar**

# Për KKP më të mirë mbi personelin e huazuar!

**Kontratës Kolektive të Punës për personel të huazuar i kalon afati në fund të vitit 2014. Kontrata e tanishme ka shumë dobësi. Bashkërisht mund ta përmirësojmë atë! Në vijim kërkesat tona kryesore për bisedime, të cilat ne bashkë me ju i kemi vendosur.**



**Me KKP-në për personelin e huazuar parashihen përmirësime të dukshme**

**Sigurim i parave ditore korrekte**

Është një kërkesë shumë e rëndësishme, pasi: KKP për personat e huazuar është shumë më e keqe se sa në sektorët tjerë, ku vlejnë vetëm një ditë afat pritjeje dhe kompensim më i lartë i të ardhurave të humbura. Kjo nuk duhet të lejohet më tej! Punëmarrësit kanë nevojë për sigurim korrekt të parave ditore. Andaj ne kërkojmë:

|                                      | <b>Deri tani</b> | <b>rishtas</b> |
|--------------------------------------|------------------|----------------|
| Afati i pritjes                      | 2 ditë           | 1 ditë         |
| Kompensimi i të ardhurave të humbura | 80%              | 90%            |

**Afate më të gjata të njoftimit të shkarkimit**

Është një kërkesë tjetër e rëndësishme. Afatet tani të vlefshme, posaçërisht për ata të cilët janë në punësim të kufizuar, janë tepër të shkurtra. Afatet e njoftimit të shkarkimit nga puna duhet të adaptohen me (OR) të drejtën obliguese dhe edhe për ata që janë të punësuar me afte të shkurtra të rriten për një muaj.

| <b>Kohëzgjatja e punësimit</b> | <b>Afate e shkarkimit deri tani</b> | <b>Afatet e shkarkimit tani</b> |
|--------------------------------|-------------------------------------|---------------------------------|
| Tre muajt e parë               | 2 ditë                              | 1 muaj                          |
| 4 deri 6 muaj                  | 7 ditë                              | 1 muaj                          |
| Nga muaji i 7-të               | 1 muaj                              | 1 muaj                          |

**Paga minimale më të mira**

Sektorët të caktuar posedojnë Kontrata Kolektive Pune të deklaruara si të detyrueshme (AVE GAV/ CCT DFO) si p.sh. sektori i ndërtimit apo ai i gastronomisë. Për punëmarrësit, të cilët punojnë në këta sektorë, mirëpo janë të punësuar si personel i huazuar, vlejnë pagat e KKP me detyrim të përgjithshëm (DP) dhe jo ato të KKP për personelin e huazuar me vlefshmërinë e pagave minimale (shih edhe intervistën në Horizonte Nr. 4). Për ata, të cilët nuk i nënshtrohen KKP me DP, vlejnë pagat minimale të KKP për personelin huazuar. Këto duhet të rriten në KKP-në e re., pasi ato janë shumë të ulëta. Ne kërkojmë rritjet vijuese:

| <b>Kategoria</b>                            | <b>Paga minimale deri tani</b> | <b>Paga e re minimale</b> |
|---|--------------------------------|---------------------------|
| Të pakualifikuarit                          | 3000.-                         | 3400.-                    |
| Të pamësuarit zona e lartë e pagave         | 3200.-                         | 3600.-                    |
| Gjysmë të kualifikuar                       | 3600.-                         | 3780.-                    |
| Gjysmë të kualifikuar zona e lartë e pagave | 3870.-                         | 4050.-                    |
| Të kualifikuarit                            | 4000.-                         | 4200.-                    |
| Të kualifikuarit zona e lartë e pagave      | 4300.-                         | 4500.-                    |

**Kërkesat tjera**

Lista e kërkesave tona nuk ka përfunduar ende: Përmirësime tjera duhet të ketë tek pushimet vjetore e ato të prindërve, përkujdesja e pensionit profesional apo kostot e trajnimeve dhe të zbatimit, si dhe tek shumë të tjera.

**Pa anëtarësi s'ka KKP!**

KKP për personelin huazuar kemi arritur ta realizojmë vetëm falë angazhimit të shumë punonjësve temporal. Edhe tani kemi nevojë për mbështetjen Tënde. Na ndihmo të ta shpërndajmë këtë informatë te kolegët Tuaj. Ose bëhu anëtarë i Unia-s dhe bashkë-vendos për KKP-në e re! Pasi pa anëtarësi të sindikatës ne nuk mundemi të kontraktojmë Kontrata Kolektive Pune!

**Aurora Garcia**

**Intervistë**



**André Kaufmann**

**Intervista KKP për personelin e huazuar**

## Pjesa e dytë e intervistës me André Kaufmann

(pjesa e parë u publikua në numrin e kaluar, Horizonte Nr. 4)

**Një pyetje e cila i preokupon edhe më tej punëmarrësit që i nënshtrohen KKP për personelin e huazuar është pensionimi i mëhershëm. A kanë ata fare të drejtë në pensionimin e mëhershëm?**

Po, kjo vlen edhe për punëmarrësit temporal. Mirëpo tek punonjësit temporal kemi të bëjmë me dy probleme. E para: Punonjësit temporal ende nuk mund ta dëshmojnë sasinë e kohës së nevojshme. Për të pasur mundësi që ta marrin një pension të shkurtuar tejkalues, punëmarrësi duhet të ketë punuar në 20 vitet e fundit së paku 10 vjet tek një ndërmarrje që i nënshtrohet KKP të vlefshme me dalje fleksibël në pension.

Problemi i dytë janë zbrazëtitë në sasinë e kohës së nevojshme. Pasi për këto 10 vitet e lartpërmendura duhet që punëmarrësi, 7 vite para marrjes së përfitimit, pandërprerë të ketë punuar në sektorin e ndërtimitarisë. Pra, nëse dikush për kohë të gjatë mbetet i papunë dhe nuk lajmërohet tek Qendra regionale për ndërmjetësim pune (RAV), apo nëse ka ndërruar sektorin e ekonomisë, i cili nuk i nënshtrohet kontratës me dalje fleksibël në pension, mund të ndodh që nuk përbushen parakushtet e këtyre 7 viteve dhe në rastin më të keq nuk mund të marrin pensionin tejkalues të shkurtuar. Andaj është e rëndësishme, që kolegët, të cilët mbesin pa punë, menjëherë të lajmërohen tek Qendra regionale për ndërmjetësim pune (RAV)!

**Çka duhet të ketë kujdes një punëmarrës/e, nëse punësohet si personel i huazuar?**

Me rëndësi të veçantë është që kontrata e punës të definon qartas dhe pa mundësinë e keqkuptimit pagën dhe orarin e punës.

**Cilat janë problemet më të shpeshta në raport me zbatimin e KKP-së?**

Koha e tepët e punës është gjithmonë temë, pasi gjithmonë provohet shmangja nga rregullat. KKP-ja rregullon mirë kohën e tepërt të punës, gjë që është formuluar në nenin 12. Nga 46 deri në 50 orë pune vlejnë si kohë e tepërt dhe duhet të kompensohet me 25% më shumë pagesë, ndërsa gjatë fundjavës me 50% më tepër pagesë. Kategorizimi i pagës gjithashtu paraqet një problem, shpesh kolegët janë të kategorizuar keq. Një kategori e re është ajo e gjysmë të kualifikuarve, e që nga 1 gushti 2013 është e deklaruar përgjithësisht e detyrueshme. Si të gjysmë të kualifikuar numërohen punëmarrësit me së paku 4 vjet përvojë profesionale në veprimtarinë që duhet ushtruar, e për të cilën ekziston arsimim profesional.

**Cilat përfundime i nxjerr ti nga ky vit i parë?**

Kjo KKP për shumë punëmarrës ka pru një përmirësim dhe ka l'ëviz gjërat nga vendi. Mirëpo ka ende dobësi dhe disa gjëra janë tek tani duke u zbatuar. Pasi që procedura e deklarimit përgjithësisht të detyrueshëm është e gjatë, ne do të fillojmë menjëherë pas pushimeve verore me bisedimet për ripërtëritjen e KKP-së. Ne duam të bëjmë përpertime posaçërisht tek pagat minimale, pasi në këtë pikë nuk kemi arritur atje ku kemi dashur të jemi. Edhe për sektorin e industrisë duhet gjetur një zgjedhje.

**Aurora Garcia**

**FAR rregullimi:** Sekretariati juaj i Unia-s me dëshirë ju këshillon për këtë çështje. Kriteret për pension të plotë janë së paku 15 vite në kuadër të 20 viteve të fundit dhe nga këto (7) shtatë vitet e fundit para marrjes së përfitimit duhet dëshmuar të jenë veprimtari e plotë e pandërprerë pune që iu është nënshtrohet KKP-së FAR (me pensionim fleksibël). Për një pension të shkurtuar duhet plotësuar këto parakushte: gjatë 20 vjetëve të fundit para shtruarjes së kërkesës për fillim të pensionimit së paku për 10 vjet të i punësuar në një ndërmarrje që i është nënshtrohet KKP-së me FAR (me pensionim fleksibël), e nga këto 7 vite para marrjes së përfitimit pandërprerë. Pos tjerash vlen: Gjatë 7 viteve të fundit para kërimit të marrjes pensionit, punësimi guxon të jetë i ndërprerë nga maksimalisht 2 vite papunësi (parakusht është: lajmërimi tek enti kompetent, sipas rregullit qendra regionale për ndërmjetësim pune/RAV). Në çdo rast preferohet këshillimi në sekretariatit Tuaj të Unia-s. Edhe të punësuarit temporal mund të **bëhen anëtarë të Unia-s**: ata sipas rregullit do të caktohen në shkallën e njëjtë të kontributeve, **kontributet e kthyer** arrin, pavarësisht nga shkalla e kontributeve, maksimum 80% i shumës së paguar të anëtarësisë.

Marrëveshja e munguar Kosovë-Zvicër për sigurimet shoqërore

# Dështim i radhës për Qeverinë dhe Republikën e Kosovës



Protestë në Zvicër kundër vjedhjes së pensioneve të punëmarrësve nga Kosova

**Të premtën, me 9 gusht, Lëvizja Vetëvendosje! mbajti konferencë për media në lidhje me çështjen e sigurimeve shoqërore të shqiptarëve dhe marrëveshjen e munguar Kosovë-Zvicër.**

Qytetarët e Kosovës që kanë punuar në Zvicër dhe që në ndërkohë janë kthyer në vendlindje, që nga marsi i vitit 2010 nuk marrin pensionet e tyre të pleqërisë, ato të trashëgimtarëve dhe pensionet e invaliditetit, edhe nëse ata kanë punuar me dekada të tëra në Zvicër dhe kanë paguar rregullisht kontributet në arkat e sigurimeve shoqërore. Gjithashtu, që nga kjo kohë (1 prill 2010) nuk paguhen edhe shtesat familjare dhe ato të fëmijëve që jetojnë në Kosovë. Përkundër kërkesave të shumta të qytetarëve të dëmtuar të Kosovës, edhe pas gati katër viteve kur është adresuar kjo çështje nga Zvicra zyrtare, ende nuk kanë filluar negociatat për një Marrëveshje të re. Anëtarët e Komitetit të Vetëvendosje!-s për Mirëqenie Sociale, Osman Osmani, tha se Gjykata Federale në Zvicër, si instanca më e lartë gjyqësore, para disa javësh në një rast ka vendosur të mos paguaj pensionet e pleqërisë dhe ato të invaliditetit qytetarëve të Kosovës që kthehen të jetojnë në Kosovë. «Vendimi godet jo vetëm invalidët e punës, por posaçërisht qytetarët që kanë punuar me vite të tëra në Zvicër dhe që janë larguar nga ky vend para moshës së pensionimit, duke llogaritur që kur të arrijnë moshën e merituar të pleqërisë të marrin edhe pensionet e tyre të fituara me shumë mund e sakrificë. Mungesa e zbatimit të Marrëveshjes diskriminon kështu mijëra qytetarë që sot jetojnë në Kosovë e që për vite të tëra kanë derdhur kontributet në arkën e sigurimit të pleqërisë e trashëgimtarëve në Zvicër duke kontribuar kështu si në mbarëvajtjen e sigurimeve shoqërore në Zvicër ashtu edhe në Kosovë përgjatë rrjedhave të rëndësishme ekzistenciale dhe shtet-ndërtuese», tha Osmani, duke shtuar se Qeveria e Kosovës, duke mos u përgjigjur në kohë e në plotni kërkesave që kishte shtruar Qeveria e Zvicrës para anulimit të marrëveshjes, i dha arsytim të mjaftueshëm kësaj të fundit për ta anuluar këtë Marrëveshjen mbi Sigurimet Shoqërorë në raport vetëm me Kosovën.

## Partneriteti i (pa)denjë

«Lëvizja Vetëvendosje! qysh atëherë pati mbështetur nismën për masivizimin e peticionit të sindikatës UNIA për këtë çështje, të përkrahur edhe nga BSPK-ja, PS dhe PSD e Kosovës. Interesat e qytetarëve të Republikës së Kosovës, kudo që ata punojnë, janë edhe interesa tonat. Qytetarët e Republikës së Kosovës që punojnë

në Zvicër duhet të kenë të drejtë ta zgjedhin vendin se ku duan të jetojnë pas pensionimit, dhe këtë zgjedhje të tyren nuk duhet ta bëjnë nën kushtet e përkeqësimit financiar. Kjo, në të vërtetë, nuk është zgjedhje por një imponim i detyrueshëm», theksoi Osmani. Ai përmendi marrëveshjet e dëmshme që po i nënshkruan Qeveria e Kosovës në dëm të qytetarëve të vet, si Marrëveshja për riatdhesim me shtetin e Zvicrës, e nënshkruar më 3 shkurt të viti 2010 nga ish-ministri i Punëve të Brendshme, Zenun Pajaziti e cila ka hyrë në fuqi më 1 qershor të po atij viti. «Me këto marrëveshje dhe veprime Qeveria e Kosovës po bart problemet sociale nga Zvicra dhe vendet e BE-së në Kosovë. Secila marrëveshje duhet të përfshijë interesat e ndërsjella. Qeveria e Kosovës nuk bënë as përpjekjen minimale që marrëveshjet si kjo për riatdhesim dhe bashkëpunim policor, të strukturoren në atë mënyrë që ligjërisht të mbrojnë shtetasit e Kosovës.», tha në fund Osmani.

## Qeveria anashkalon kuvendin

Kuvendi i Kosovës, me 16 shtator të vitit 2010, fal angazhimin të deputetit të atëhershëm Emrush Xhemajli dhe e mbështetur njëzëri nga të gjithë deputetët e Kuvendit të kaluar të Kosovës, pati obliguar Qeverinë e Kosovës që në politikën sociale qeveritare këtë marrëveshje ta trajtoj si prioritet. Përkundër këtij obligimi qeveria e re e Kryeministrit Thaçi nuk ndërmori ndonjë hap përmbajtësor dhe serioz për ndryshimin e situatës. Gjatë kësaj konference, Emrush Xhemajli përmendi të tetë këto rekomandime, duke ardhur në përfundim se ato nuk janë realizuar, përkundrazi bile janë injoruar tërësisht.

Ai tha se që më shumë se tre vite, Qeveria e Kosovës asnjëherë nuk e ka pasur këtë prioritet në kuadër të prioritetëve të veta. «Megjithëse ka

kaluar kohë e mjaftueshme Qeveria nuk ka arritur të procedojë gjithë rregullativën ligjore për të qenë e gatshme që të rifillojë negociimin e marrëveshjes. Është formuar grupi punues që merret me çështjet që kanë të bëjnë me koordinimin e aktivitetëve, që e bëjnë të mundur arritjen e Marrëveshjes Zvicër-Kosovë për Sigurimet Shoqërore, por çka ka ndodhur? Sa herë nuk do të kryej një punë Qeveria e Kosovës me dëshirë fshihet prapa grupeve ndërmitore. Faktësisht edhe me këtë grup është duke ndodhur e njëjta gjë: joefikasiteti dhe mungesa e rezultateve», tha Xhemajli. Lidhur me takimin e lartë qeveritar Kosovë-Zvicër (pika 6), Xhemajli tha se Kosova nuk ka arritur të bëjë kurrfarë takimi të tillë. As Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet Qeverisë së Kosovës dhe Qeverisë së Zvicrës për zgjidhjen adekuate të përkohshme, deri në arritjen e marrëveshjes së re (pika 7), nuk është bërë deri tash. «Po të ishte në nivel të detyrës Qeveria e Kosovës do të duhej që në vend të marrëveshjeve të dëmshme si ajo me Serbinë, të përgatiste një pako ligjesh për marrëveshjen që lehtëson dhe ndihmon jetën e qytetarëve tanë dhe ato do të duhej të kaloheshin në mënyrë të përspejtuar që të fillonin dhe mbaronin negociatat për marrëveshjen Kosovë-Zvicër për sigurimet shoqërore», u shpreh Xhemajli.

## Mobilizimi i domosdoshëm

Për këto 4 vite qeveria e Kosovës nuk bëri pothuajse asgjë për këtë Marrëveshje. Kjo, tregon paaftësinë dhe papërgjegjësinë e saj. Gjyqi Administrativ Federal në të gjitha rastet u ka dhënë të drejtë shtetasve të Kosovës në ankesat e tyre dhe ka kërkuar që marrëveshje të zbatohet edhe më tej. Mërgimtarët ftohen që të mobilizohen dhe bashkë me partnerë e dëshmuar dhe të tjerë të mundshëm gjithandej të angazhohen dhe të luftojnë për të drejtat e tyre legjitime me të gjitha mjetet e mundshme demokratike.

⇨ Lëvizja Vetëvendosje!  
Komiteti për Mirëqenie Sociale



Pamje nga konferenca për media e Vetëvendosjes!

# Ju pyesni, Unia përgjigjet



## Alkooli në timon: Si reagojnë sigurimit?

**Nën ndikimin e alkoolit kam shkaktuar një aksident me dëme të mëdha. Unë jam lënduar konsiderueshëm dhe jam i paaftë për punë. Si reagon sigurimi i automjeteve dhe si qëndron puna me sigurimin aksidental profesional (UVG)?**

Sipas normativës ligjore përgjegjësia e të siguruarit është e kufizuar, nëse i siguruari apo personi që me të drejtë përfitimi nga neglizhenca e vrazhdë ka shkaktuar një ndodhi me dëme. Me neglizhencë të vrazhdë kemi të bëjmë, kur lihen anash rregullat elementare të kujdesit, të cilat do ti ndiqte e respektonte çdo njeri i arsyeshëm në të njëjtën situatë dhe në të njëjtat rrethana. Kushdo që në gjendje të alkoolizuar shkaktonte aksident komunikacioni jep të përbushjes faktike të neglizhencës së vrazhdë. Për këtë arsye të siguruarit në masë të arsyeshme do ti shkurtohet shërbimet apo do ti kërkohet kthimi për dëmet e paguara palës së tretë nga shkaku i ngasjes së gabuar. Sipas ligjit për komunikacion rrugor vlen paaftësia e ngasjes për shkak të ndikimit të alkoolit (të dehjes) në çdo rast si provë faktike, nëse një vozitës ka koncentrik alkooli në gjak nga 0,5 promilë apo më shumë, apo nëse në trup ka një sasi alkooli, e cila qon në një koncentrik të tillë alkooli në gjak.

## Sigurimi aksidental shkurton shërbimet

Edhe me serioze mund të jenë pasojat e vozitjes në gjendje të alkoolizuar për ngasësin e automjetit në rast të shkakimit të kostos me pasojë lënduese. Nëse vozitësi fajtor punon mesatarisht më shumë se 8 orë në javë, në të vërtetë sigurimi aksidental i punëdhënësit (UVG) merr përsipër harxhimet e shërbimit, mirëpo shërbimet tjera përfituese (paratë ditore, kompensimi i invaliditetit, etj.) do të shkurtohen dukshëm. Nëse ngasësi është i siguruar për aksidente vetëm tek arka e sigurimit të tij shëndetësor, atëherë ai përfiton vetëm për kostot e shërbimit – mirëpo edhe nëse ka pasur të kontraktuar sigurime vullnetare shtesë për përfitime materiale në rast aksidentesh, edhe atëherë do të përfitonte në mënyrë të reduktuar.

Burimi: Schweizer Versicherungsverband (ASA/SVV)

## Aksident me automjet zyrtar në rast ngasjes për nevoja private: Si është e siguruar?

**Unë me leje të punëdhënësit tim kam të drejtë të përdori automjetin zyrtar për nevoja private. A paguan sigurimi im privat personal, nëse unë dëmtoj automjetin në rast të ngasjes private?**

Për dëmet në automjet të punëdhënësit tuaj nuk keni mbrojtje sigurimi nga sigurimi juaj privat personal, pasi përjashtohen në mënyrë eksplicite nga çdo mbulesë kërkesat e mundshme të punëdhënësit. Shumica e kompanive të sigurimit ofrojnë në kuadër të sigurimit privat personal - përmes premisë shtesë apo të integruar në mbulesën bazë – mirëpo mbulesa vlen «për përdorim të rastit e jo për përdorim të rregullt të automjeteve të huaja»; për të pasur sigurim mbrojtës, duhet pra të plotësohen parakushtet e caktuara, si mospërdorimi i rregullt të automjetit. Kjo përzgjedhje sigurimi ofron një mbrojtje të mirë, nëse ju fjala bie huazon automjetin e një të njohuri tuaj.

## Sigurimi (i plotë) gjithëpërfshirës i nevojshëm

Mbulimi e dëmeve në automobil të punëdhënësit tuaj vjen në shprehje vetëm nëse posedoni sigurimin e plotë gjithëpërfshirës. Andaj është shumë me rëndësi, që punëdhënësi për automjetet që ua jep në përdorim punonjësve të vet edhe për përdorim privat të ketë përzgjedhur një sigurim gjithëpërfshirës. Rekomandohet që para huazimit të automjetit zyrtar për nevoja private të siguroheni se çfarë sigurimi mbrojtës ka përzgjedhur punëdhënësi juaj.

Burimi: Schweizer Versicherungsverband (ASA/SVV)

Impressum: Bellage zu den Gewerkschaftszeitungen work, area, Événement syndical | Herausgeber Verlagsgesellschaft work AG, Zürich, Chefredaktion: Marie-José Kuhn; Événement syndical SA, Lausanne, Chefredaktion: Sylviane Herranz; Edizioni Sociali SA, Lugano, Chefredaktion: Claudio Carrer | Redaktionskommission A. García, D. Filipovic, E. Sariasslan, M. Martin, M. Mendes, O. Osmani | Sprachverantwortlich Osman Osmani | Layout C. Lonati, Unia | Druck Ringier Print, Adligenswil | Adresse Unia Redaktion «Horizonte», Weltpoststrasse 20, 3000 Bern 15, osman.osmani@unia.ch



Die Gewerkschaft.  
Le Syndicat.  
Il Sindacato.

www.unia.ch